



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI -- KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Mamushë

Nr. i referencës: 626-23-991-2-2-1

Me 13.04.2023

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 4 paragrafi 4.1 pika (c), nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-991-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-002-2-2-1

II

I njëjti duhet të rishpallet sipas procedurave të prokurimit pas afatit për ankesa.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 23.02.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë” me nr. të prokurimit 626-23-991-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-002-2-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë dorëzuar gjashtë (5) operator ekonomik.

Komisioni vlerësues, pas ekzaminimit dhe vlerësimit të secilit tender veç e veç, ka konstatuar se të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës, kanë ofruar tender të papërgjegjshëm, pasi që nuk i kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe në disa raste kanë dorëzuar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut, andaj edhe kanë rekomanduar që të anulohet aktiviteti i prokurimit në fjalë dhe të rishpallet pas afatit për ankesa.

Pas shqyrtimit të rekomandimit të komisionit vlerësues, është konstatuar që me të vërtetë, asnjëri nga Operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk ka qenë i përgjegjshëm në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe me nenin 4 paragrafi 4.1 pika (c) të Rregullores për Prokurimin Publik 01/2022 .

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

